

fshatin **Zhvilivodë/Zilivoda** [bjeshka e **Çiçavicës/Çiçavica**]. Të nesërmen [23.09.1998], në çastet kur forcat serbe e bombardonin pyllin, Emini gjendej në traktor. Një granatë ka eksploduar në afërsi dhe cifat e saje lanë të vdekur në vend. Trupi i tij kishte mbetur në rimorkion e traktorit, ndërsa anëtarët e familjes së tij kishin ikur nga paniku i krijuar. Të nesërmen, i biri i tij ishte kthyer në vendin e ngjarjes dhe e kishte gjetur traktorin e familjes së tij, por në të nuk e gjeti kufomën e babait të tij. Mbetjet mortore të Eminit deri më sot nuk janë gjetur. Në listën e KNKK-së, zhdukja e tij është regjistruar me numër BLG-804392-01

**Burimet:** deklarata M.J, FDH-29934; deklarata A.LI, FDH-38512; KMDLNI, *Buletini*, num. 9, october-december 1998, 122, FDH-23857; KNKK, *Persona të zhdukur..*, FDH-9795.

### Idriz (Mehmet) Mehmeti

(1915, shqiptar nga Oshlani/Ošljane, komuna e Vushtrrisë/Vuçitrn, bujk, njëmbëdhjetë fëmijë)

Idrizi i moshuar dhe i biri Zeqiri ndenjën në fshat pas datës 20.09.1998, kur shumica e banorëve e braktisën Oshlanin/Ošljane, për shkak të sulmeve të paralajmëruara të forcave serbe. Në datën 22.09.1998, pas hyrjes së forcave serbe, Idrizi dhe Zeqiri, me disa bashkëfshatarë, kishin ikur në pyll, ku e kaluan edhe natën. Të nesërmen, më 23.09.1998, ushtarët serb i gjetën burrat shqiptar. Zeqiri me të tjerë arritën të iknin me vrap, kurse vetëm Idrizi ka mbetur në pyll. Së shpejti, Zeqiri i dëgjoi të shtënat nga drejtimi i vendit ku Idrizi kishte mbetur vetëm. Pas dy ditësh, një bashkëfshatar, Avdyl Tahiri, e gjeti trupin e Idrizit në pyll [Oshlan/Ošljane]. Po atë ditë, pjesëtarët e UÇK-së e varrosën në varrezat në Oshlan/Ošljane. Pas lufte, në qershor të vitit 1999, familjarët i rivarrosën mbetjet e tij mortore në Varrezat e Dëshmorëve të Luftës në Oshlan/Ošljane. Pas identifikimit të kryer [gusht 2000], Idrizi sërish u rivarros në varrezat në Oshlan/Ošljane [shtator 2000].

**Burimet:** deklarata F.H, FDH-19399; KMDLNI, *Buletini*, num. 9, october-december 1998, 122, FDH-23857.

### Hamit (Maliq) Hyseni

(6.07.1953, shqiptar nga Oshlani/Ošljane, komuna e Vushtrrisë/Vuçitrn, punëtor, shtatë fëmijë, pjesëtar i UÇK-së)

Hamiti aderoi në UÇK në mars të vitit 1998. Kur nisi sulmi i forcave serbe në Oshlan/Ošljane, më 22.09.1998, familja e tij u strehua në pyll, kurse ai ndenji në fshat me pjesëtarët e forcave të UÇK-së. Gjeti vdekjen më 23.09.1998 në luftimet me forcat serbe. Pas tërheqjes së forcave serbe, djali i Hamitit, Naseri, me disa kushërinj dhe pjesëtarë të UÇK-së, e varrosën Hamitin në varrezat e fshatit më 26.09.1998. Pas lufte, në qershor 1999, familjarët mbetjet mortore të tij i rivarrosën në Varrezat e Dëshmorëve të Luftës në Oshlan/Ošljane. Patologët ndërkombëtar i kanë zhvarrosur mbetjet mortore të tij më 22.08.2000, dhe i dërguan në Institutin për Mjekësi Ligjore në Rahovec. Familjarët e rivarrosën Hamitin më 26.09.2000 në të njëjtin vend.

**Burimet:** deklarata Q.H, FDH-29932; J. Martinsen, *Regjistri..*, FDH-26092; KMDLNI, *Buletini*, num. 9, october-december 1998, 122, FDH-23857; ICTY, IT-05-87 (M. Milutinović dhe të tjerë), Ex.P01162, FDH-35263.

### Veseli (Brahim) Fazliu

(7.01.1958, shqiptar nga Gradica/Gradica, komuna e Glogocit/Glogovac, saldues, pesë fëmijë)

Veseli ka punuar si saldues në *TE Obiliq/Obilic* 16 vite me radhë. Me familjen e vet e kishte braktisur shtëpinë dhe fshatin Gradicë/Gradica [Glogoc/Glogovac] më 22.09.1998, kur forcat serbe nisën sulmin ndaj UÇK-së. Ata u strehuan në pyllin e bjeshkës së **Çiçavicës/Çiçavica**, përmbi fshatin **Beçuk/Bençuk**. Atje kishte shumë njerëz nga fshatrat përreth. Në datën 23.09.1998, forcat serbe po i afroreshin malit. Veseli me Beqirin nga Dobrosheci/Dobroševac [Glogoc/Glogovac] dolën nga pylli për të parë se çka po ndodhte. Pjesëtarët e forcave serbe ndodheshin 50 metra më larg dhe menjëherë e hapën zjarrin. Veseli u qëllua për vdekje, kurse Beqiri arriti të iktë. Pas dy ditësh, më 25.09.1998, babai i Veselit me disa ushtarë të UÇK-së e morën trupin e Veselit dhe e varrosën në varrezat e fshatit